

**GJNPJ Lënda nr. IT-04-84bis-T (Prokurori kundër Haradinajt dhe të tjerëve)
Trupi gjykues I: Aktgjykimi, 3.4.2008.
f. 167-168, paragrafi 296-297.**

„Provat mjekoligjore në mënyrë serioze orientojnë drejt asaj se (Idriz Hoti) është vrarë. Trupit gjykues nuk i janë paraqitur kurrfarë provash se Idriz Hoti ka qenë nën kompetencë të UÇK-së si dhe as prova mbi rrethanat ose kryerësit e vrasjes. Idriz Hoti ka qenë i martuar me një myslimane boshnjake dhe e ka përkrahur LDK-në. Megjithëkëtë, ai po ashtu e ka përkrahur edhe UÇK-në dhe, para se të shihet për herë të fundit, e ka shprehur qëllimin që t'i bashkohet UÇK-së. Trupit gjykues i janë paraqitur prova se përafërsisht në kohën kur Idriz Hoti është parë për herë të fundit në Cërmjan/Crmljane ka qenë nën kontrollin e UÇK-së dhe se në atë zonë janë zhvilluar luftime midis UÇK-së dhe forcave serbe. Një kohë të shkurtë para se ai të shihet për herë të fundit, pjesëtarët e ushtrisë serbe e kanë kërcënuar dhe e kanë rrahur. Madje edhe sikur Idriz Hoti për herë të fundit të shihej në territorin nën kontroll të UÇK-së, Trupi gjykues në bazë të provave nuk mundet në mënyrë të arsyeshme për ta përjashtuar mundësinë se vrasjen e kanë kryer forca ose persona të tjerë, që nuk kanë qenë të lidhura me UÇK-në.

297. Për këtë arsye, madje edhe nëse supozohet se Idriz Hoti është vrarë, Trupi gjykues nuk mundet që në bazë të provave të cilat i janë paraqitur jashtë dyshimit të arsyeshëm të përfundoj se kush e ka kryer vrasjen, me cilin grup eventualisht ka qenë i lidhur kryerësi dhe nëse vrasja është kryer derisa viktimja ka qenë nën kompetencë të UÇK-së.”